



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 514 Prot.

Tiranë, më datë 25.10.2024

VENDIM

Nr. 454, datë 25.10.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saç”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.10.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të gërmimit arkeologjik të shpëtimit, hartuar nga individi i licencuar z. Luan Përzhita në kuadër të projektit “Rindërtimi i gjimnazit “Gjergj Kastrioti” Durrës”, Brenda kufirit Zonë Arkeologjike “B” Durrës, me zhvillues **Bashkia Durrës**;
2. Bazuar në rezultatet e gërmimit arkeologjik, si dhe raportin e hartuar nga z. Luan Përzhita, IKTK të fillojë procedurën për deklarimin e interesit kulturor për sitin arkeologjik të zbuluar në kuadër të projektit “Rindërtimi i gjimnazit “Gjergj Kastrioti” Durrës”, sipas përcaktimeve nenit 62 të Ligjit nr. 27/2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe muzetë”;
3. Subjekti i licencuar në arkeologji z. Luan Përzhita duhet të kryejë procesin e konservimit të gjetjeve arkeologjike dhe të përgatisë kartelat për regjistrimin e objekteve pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;
4. Pas përfundimit të konservimit dhe studimit të objekteve të zbuluara nga gërmimi arkeologjik, në përputhje me afatet e përcaktuara në *Rregulloren e Kriteve të Ushtrimit të Profesionit të Arkeologut* (Vendim KKA nr. 2 datë 30.01.2009), gjetjet arkeologjike të depozitohen pranë fondeve të Muzeut Arkeologjik të Durrësit;
5. Subjekti i licencuar z. Luan Përzhita, ka detyrimin ligjor të botimit dhe publikimit të rezultateve të këtij gërmimi arkeologjik brenda tre (3) viteve nga përfundimi i tij;
6. Një kopje e dokumentacionit fizik të hartuar në terren duhet të dorëzohet pranë Arkivit Teknik të IKTK-së, brenda 30 ditëve nga miratimi i Raportit Arkeologjik në KKTKM;
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
8. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI



KRYETAR
Blendi GONXHJA